



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2021:262935

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05298984

KPPP.nr. 1937/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Besarti Company” Sh.P.K., me seli në Vushtri, me bazë juridike përmbarimi sipas dokumentit të besueshëm, jashtë seancës, me datë 07.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Vushtri, Departamenti i Përgjithshëm për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” Sh.A., me seli në Prishtinë dhe debitorit “Besarti Company” Sh.P.K., me seli në Vushtri.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin E.nr. 230/14, të datës 12.03.2014, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” Sh.A., ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit “Besarti Company” Sh.P.K., me seli në Vushtri, për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej EUR 352.87. Ndërsa, kjo gjykatë, me Aktvendimin E.nr. 230/14, të datës 24.06.2016, është shpallur jo kompetente për të

vendosur në këtë çështje përmbarimore, dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Vushtrri.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega Vushtrri, me Aktvendimin CP.nr. 311/2016, të datës 26.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje, ndërsa lënda i është dërguar Gjykatës Komerciale në Prishtinë, si gjykatë kompetente për të procedura në këtë çështje përmbarimore.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Mitrovicë, Dega Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbarimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbarimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përbarimore është caktimi dhe zbatimi i përbarimit nga gjykata si organ përbarues sipas propozimit për përbarim të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore Mitrovicë, Dega Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1937/23, datë 07.02.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.